



Chippewa Valley Virtual Academy (CVVA)

Q&A for Families

Akademia Virtuale e Chippewa Valley

Q & A per familjet

Chippewa Valley Schools do të vazhdojnë të ofrojnë mundësinë e një eksperience të të mesuarit në distancë për familjet e nxenesve në shkollat e mesme për vitin akademik 2023-24. Stafit i distriktit tona, duke përfshirë administratën dhe mesuesit të cilët janë duke dhënë ose mbështetur mesimdhënien virtuale, janë të angazhuar për të ofruar të njëjtat cilësi mesimdhënie për nxenesit që studiojnë virtualisht sikurse ata që marrin pjesë fizikisht në ambientet shkollore. Me poshtë janë disa pyetje dhe përgjigje përsa i përket mesimdhënies virtuale.

Si do të duken klasat e CVVA?

- Mesimdhënia dhe kurrikulumit virtual do të jete në përputhje me standardet e kurrikules së Michiganit.
- Studentet duhet të ndjekin shpjegimin e mesimit, të marrin pjesë në diskutime, ose të behen pjesë e përgjësive të tjera në klase duke qenë pjesë e CVVA.
- Studentet duhet të dorezojnë detyrat dhe të frekuentojnë mesimin rregullisht nëse dëshirojnë që të jete pjesë e CVVA.
- Studenteve do t'u kërkohej që të bëjnë testimet tradicionale, të plotësojnë detyrat e përditshme, dhe të krijojnë lidhje me mesuesin gjatë eksperiencës virtuale.
- Në disa raste, nxenesve do t'u kërkohej që të vijne në shkollë për disa testimet.
- Nxenesve do t'u kërkohej të vijne në shkollë për testimet e detyrueshme nga shteti.

Cfare aftesish nevojiten për suksesin e nxenesve në mjedisin e të mesuarit online?

- Që nxenesit të jete të suksesshëm në të të mesuarit virtualisht, duhet të jete të organizuar dhe të ndjekin një rutinë tradicionale.
- Nxenesit që regjistrohen në CVVA duhet të kenë vullnet të punojnë në mënyrë të pavarur.
- Nxenesit duhet të jete të aftë të analizojnë, të mendojnë në mënyrë kritike, dhe të reflektojnë përsa i përket të të kuptuarit e performancës në shkollë në mënyrë që të kërkojnë ndihmë nga personat e përfshirë në këto qasje.
- Nxenesit dhe familjet duhet të kuptojnë që nxenesve ju duhet një person i rritur në shtëpi që të ndihmojë në mënyrë që femija të jete i suksesshëm në CVVA.

Chippewa Valley Virtual Academy (CVVA) Q&A for Families

<p>A duhet te blejme kompjuter qe te regjistrojme femijen tone ne CVVA?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nxenesit qe jane regjistruar ne CVVA do te lejohen te perdorin nje laptop nga distrikti per klasat e tyre online. • Nxenesve ne CVVA do ju nevojitet internet, Wi-Fi i siguraur nga ana e tyre.
<p>A mundet qe femija im te marri pjese ne aktivitetet kurrikulare dhe jashte kurrikulare?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nxenesit qe jane regjistruar ne CVVA nuk lejohen te marrin pjese ne aktivitete qe zhvillohen gjate dites ne shkollat tona tradicionale. • Nxenesve te regjistruar ne CVVA do ju lejohet te marrin pjese ne aktivitetet ekstrakurrikulare pas programeve dhe aktiviteteve shkollore.
<p>Cfare klasa mundet student te marrin ne CVVA?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Klasat per CVVA do te jene te disponueshme vetem nese numri i nxenesve qe do te marri kete klase eshte i mjaftueshem per te krijuar nje klase te plote. Klasat me nje numer te vogel nxenesish nuk do te ofrohen. Duke u bazuar ne numrat e CVVA te vitit 22-23, ka shume gjasa qe shumica e klasave te ofrohen nga nje ofruer i jashtem i akredituar, por do te kete mesues te certifikuar nga Michigan-i. • Nxenesit e shkollave te mesme te regjistruar ne CVVA do te kene orarin mesimor te krijuar bazuar ne formularet e kerkeses se klasave te cilat i kemi ne dosje. Ne rastet kur klasat e kerkuara nuk jane te disponueshme ose nuk ofrohen, keshilluesi i shkolles do te ofroje nje klase tjeter te pershtatshme e te ngjashme ne menyre qe te pershtatet me kerkesat per diplomim . • Ne akoma nuk mund te vendosim emrat e klasave qe do te ofrohen online, sepse ato varen nga regjistrimi i nxenesve dhe numri i kerkesave per klasat.
<p>Perse po behet regjistrimi ne kete kohe? A do te kete nje periudhe regjistrimi shtese?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Procesi i berjes se orarit mesimor ne shkollat e mesme eshte i nderlikuar. Regjistrimet ne CVVA ne kete kohe do ti jape mundesi distriktit te ndertoje oraret mesimore, te plotesojne kerkesat e studenteve, zgjedhjen e stafit te pershtatshem per secalin nivel dhe te zgjedhin mesuesit qe plotesojne nevojat per kete orar mesimor. • Regjistrimi ne CVVA eshte nje angazhim 1-vjecar dhe duhet te konsiderohet me kujdes perpara marrjes se vendimit per fillimin e procesit te regjistrimit. • Nuk do te kete nje periudhe tjeter per regjistrimin ne akademine virtuale.
<p>Cfare ndodh nese femija jone ka IEP ose 504?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Perpara regjistrimit ne CVVA, prinderit e nxenesit me planet IEPs or 504 duhet te kontaktojne menaxherin e kesaj ceshtjeje, punonjesit sociale, ose keshilluesit ne shkolle per te diskutuar nese FAPE mund te mundesohet edhe per CVVA.

<p>Cfare ndodh nese femija jone merr mbeshtetje per te mesuarin e gjuhes Angleze?</p>	<ul style="list-style-type: none"> Mjedisi virtual eshte vecanerisht sfidues per nxenesit qe mesojne gjuhen angleze. Departamenti EL inkurajon familjet te konsiderojne mundesine e te mesuarit ne person sepse kjo eshte menyra e duhur per te marre ndihmen e duhur me anen e mesimdhencies se drejperdrejte.
<p>A mund te regjistrohemi ne veres?</p>	<ul style="list-style-type: none"> Fatkeqesisht, ne kemi disa kufizime si rezultat i berjes se orarit mesimor, i cili kerkon shume kohe dhe impenjim. Ne na nevojiten familjet qe te aplikojne per modelin e te mesuarit ne distance tani ne menyre qe te ndertojme oraret mesimore.
<p>Cfare ndodh nese femija jone nuk ecen mire ne CVVA?</p>	<ul style="list-style-type: none"> Mesuesit, administruesit, dhe stafi suportues do te punoje me familjet e studenteve qe kane kane veshiresi ne te te mesuarit ne distance dhe do te konsiderojne te gjitha menytrat e mundshme per te mbeshtetur nxenesit e tyre.
<p>A duhet te regjistrohesh ne CVVA per vitin 2023-2024 ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> Cdo njeri qe eshte i interesuar ne CVVA per shkollen a mesme per vitin akademik 2023-2024, duhet te regjistrohet ne program. Askush nuk do te vendoset automatikisht ne program. Nese ju deshironi qe femija juaj qe eshte ne shkollen e mesme te jete pjese e CVVA, ju lutem sigurohuni qe ju te keni nje llogari active ne portalin e prinderve(Parent Portal). Vetem nxenesit e regjistruar plotesisht te Chippewa Valley kane akses ne kete portal. E vetmja menyre per te marre pjese ne CVVA do te jete nepermjet portalit te prinderve duke plotesuar formularin e kerkuar. Dritarja per tu bere pjese e CVVA do te mbyllet te Enjten, 20 Prill, 2023. Sapo familja te plotesoje formularet per CVVA, hyrja ne CVVA do te vendoset duke u bazuar ne hapesiren dhe klasat qe jane ne dispozicion. Formularet do te kene oren e plotesimit ne menyre qe te sigurohemi qe nxenesit jane vendosur ne program sipas rradhes qe ata kane bere dergimin e aplikimit. Familjet do te njoftohen per vendosjen ose orarin mesimor te femijes se tyre ne CVVA veren e 2023. Nese ju jeni i ri ne district, nxenesi duhet te regjistrohet ne shkolle perpara se te marri hapin per regjistrimin ne CVVA. Filloni procesin e regjistrimit online tek https://ecollect.accelaschool.com/chippewa.
<p>Cfare ndodh nese nuk duam qe ti bashkohemi?</p>	<ul style="list-style-type: none"> Nese femija juaj eshte nje nxenes i Chippewa Valley dhe ju keni planifikuar rikthimin fizikisht ne shkolle, femijes juaj do te vendoset automatikisht ne mjedisin tradicional te te mesuarit (prezencen fizike ne shkolle) per vitin akademik 2023-2024.

Je ne kerkim per me shume informacion?

Nese ju keni me shume pyetje, ju lutem dergoni nje email tek cvva@cvs.k12.mi.us.



Ose

Visitoni fagen zyrtare te distriktit per CVVA tek:

<https://www.chippewavalleysschools.org/academics/chippewa-valley-virtual-academy/>

Our Mission

Inspiring and empowering learners to achieve a lifetime of success.

